

Analiza&Komente

Kur barazia gjinore ekonomike (nuk) futet në rend të ditës

Pasi që tashmë kaloi euforia e 8 marsit dhe e diskutimeve mbi kuptimin e kësaj "feste" apo dite ndërkombëtare, dhe pas përfundimit të ofertave super kreative të produkteve dhe shërbimeve për nënat, motrat dhe gratë tona, është koha të ulemi dhe pak më seriozisht t'a diskutojmë ndikimin e gruas në strategjinë e zhvillimit ekonomik të vendit tonë (po patëm strategji...).

Asnjë diskutim mbi zhvillimin ekonomik të Kosovës nuk është i kompletuar pa prekjen e temës së barazisë gjinore. Jo i barazisë të cilën e garanton ligji dhe e drejta kushtetuese, por për llojin e barazisë që e kufizon shoqëria, e që ka ndikim themelor në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Fundja investimi në gruan ndihmon përsheptimin e zhvillimit të ekonomive lokale dhe lehtëson zhvillimin e shoqërisë së barabartë. Thënë më shkurt, barazia ekonomike e grave është gjë e mirë për biznes. Mirëpo, gratë, ky resurs jo i shfrytëzuar sa duhet, e që përbën gjysmën e popullsisë së vendit tonë, gjysmën e talentit, dhe medemos gjysmën e fuqisë punëtore, nuk po përdoret, nuk po përmendet, e më keq se kaq, nuk po merret në konsideratë.

Një artikulli shkruar në vitin 2012 në Reuters nga Katie Shulz flet për studimet e Bankës Botërore, të cilat tregojnë se shtetet që në strategjitë e tyre zhvillimore në fokus e kanë vënë barazinë gjinore shohin zhvillim më të fuqishëm ekonomik, se sa ato shtete në të cilat aspekti gjinor nuk zë vend në strategjitë e tyre ekonomike.

Investimet në kapitalin njerëzor, shëndetësi dhe edukim të grave janë thelbësore për zhvillimin ekonomik. Shumë shkriime e studime theksojnë se gratë e shëndetshme dhe të edukuara mirë kanë më shumë mundësi të përfshihen në aktivitete produktive, të marrin guximin të kërkojnë punë, si dhe të kenë të ardhura më të mira në të mirën e tyre si dhe të tërë shoqërisë.

Konferenca botërore e Kombeve të Bashkuara për zhvillim të vazhdueshëm (apo e quajtur Rio +20), (2012), shfaq disa statistika botërore, ku shpjegoi se gratë, mesatarisht riinvestojnë rreth 90% të të ardhurave të tyre në shtëpi/fëmijë. Ky indikator tregon se në të gjithë botën, e jo vetëm në Kosovë, një grua e edukuar ka më shumë gjasa që këto të ardhura ti shpenzojë për mirëqenien dhe edukimin e fëmijëve

punësuar e as nuk kërkojnë punë [...]". Do të thotë gati 80% të grave nuk janë fare pjesë e tregut të punës, sepse ato gra nuk kanë kohë e as burime të jenë aktorë ekonomik; për shkak të mos qasjes, për shkak të barrës së kujdesit ndaj shtëpisë, fëmijëve, të vjetërve, dhe për shkak se gruaja nuk ka kohë e burime të jetë aktorë ekonomik.

Sot, në sallone ku duhet të diskutohet mbi ndikimin ekonomik të gruas në ekonomikë e brishtë të vendit tonë, diskutimi shtyhet në aspektin social, në kulturë, e në punë që "by default" i takojnë gruas që t'i bëjë. Mundësitë e ofruara në edukim, shëndetësi, punësim, në ofrimin e kuotave për gratë, ndikojnë në mirëqenien e gruas, të komunitetit, dhe si përfundim, në mirëqenien sociale dhe ekonomike të një vendi. Duhet zhvilluar një vizion i përbashkët me konsensus eksplisit dhe përkushtim për fuqizimin ekonomik të gruas duke rritur kështu vetëdijësimin publik dhe duke punuar me burra për promovimin e barazisë gjinore dhe ekonomike në vend. Janë për t'u admiruar gratë e suksesshme në Kosovë, ato jo vetëm se i tejkaluan pengesat e të bërit biznes në kushtet tona, barriera të cilat nuk pyesin për gjininë e personit në fjalë, gruaja e suksesshme, i tejkaloi edhe barrierat sociale në shoqëri, ato barrierat të paprekshme e të padukshme, por me ndikim demotivues.

Lexuesit e këtij shkrimi mund të argumentojnë se Kosova ka probleme më të mëdha: deficit tregtar, papunësi në përgjithësi, e korrupsion. Aspekti gjinorë është pjesë e këtyre problemeve - korrupsioni rëndon të varfërit dhe grupet e marginalizuara, e gratë, në Kosovë, janë pjesë e këtyre grupeve, të marginalizuara. Gratë mbesin të nën-përfaqësuar si dhe varfëra, si ekonomikisht ashtu edhe për nga mundësitë. Në ekonomi këto shkojnë krahas njëra tjetrës - prioritizimi i objektivave ekonomike nuk mund të vazhdojë më duke lënë anash aspektin gjinor në ekonomi, duke përjashtuar gjysmën e fuqisë punëtore në vend. Një raport i IMF-së argumenton se Kosova ka fuqi të shtrenjtë punëtore në krahasim me efijencën e punës, kështu që as bizneset e OJQ-të nuk duhet të mbyllin sytë kundrejt një zgjidhjeje që e kemi parasysh dhe me kokëfortësi refuzojmë ta përdorim. Barazia gjinore në aspektin ekonomik nuk



Edona Kurtolli

Sallonet e së martës janë një rismë (avore e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D). Salloni ka format gjysmë-formal sipas mequllës Chatham House dhe pa prani të mediave. Diskutimi mbledh rath vetes eksperte e analiste, politikanë e publicistë për të reflektuar dhe kërkuar konsensus rabi temat e përzgjedhura. Fjala e hapjes postohet në www.youtube.com/user/TuesdaySalon. Secili Salon përcjelllet me një editorial që publikohet në gazetën Zëri të martën e ardhshme. Podcastet hazuar në editorialet mund të gjenden në d4d-ks.org/sallonet/podcast-per-sallonet. Sorte (e marte) në ora 16:45 Salloni i radhës me temën "Teknologjia kundër korrupsionit: Si mundet një uebfaqe apo aplikacion t'i fuqizojë qytetarët?"

për mirëqenien dhe edukimin e fëmijëve të saj. Investimi në kapitalin njerëzorë ka ndikim pozitiv afatshkurtër dhe afatgjatë në shoqëri dhe mirëqenie. Raporti nga Instituti D4D "Sa kushton Patriarkati" tregon më së miri për mos-përfshirjen e grave në tregun e punës, pengesë kjo për zhvillimin ekonomik të vendit. Po e citoj vetëm fillimin e raportit, në fakt po e citoj parathënien e raportit nga edituesit: "[...] vetëm një nga dhjetë gra në Kosovë është e punësuar, dhe vetëm një nga dhjetë do të dëshironte të gjente punë. Tetë nga dhjetë nuk janë të

Barazia gjinore në aspektin ekonomik nuk duhet të ngelet vetëm si kërkesë e pa përbushur apo thjeshtë si një aspiratë të cilën e përmendim çdo 8 mars, e që mbetet si kapitull i shkruar në dokumente të shumta nga konsulentë ndërkombëtarë. Kjo temë mbi barazinë duhet të jetë temë integrale për zhvillim të vazhdueshëm ekonomik duke e vënë jo vetëm si kapitull thelbësor në strategji të zhvillimit ekonomik të Kosovës por edhe si temë transverzale të çdo sektori, përfshirë edhe sektorët ku përfshirja e gruas tingëllon tabu.